

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, Departamenti i Pergjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Enes Mehmeti dhe procesmbajtësen Minire Krasniqi, në çështjen juridike, sipas padisë së paditësit [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] të cilin me autorizim e perfaqëson [REDAKTUAR] i nga [REDAKTUAR] paditues KS "[REDAKTUAR]" me seli në [REDAKTUAR] të cilën e perfaqëson me autorizim [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] për shpërblim dëmi material dhe jomaterial, në seancën e mbajtur me datë 22.08.2013, në prezencën e të autorizuarit të paditësit dhe paditësit a në mungëve të perfaqësuesit të të paditues, në të njëjtën ditë, muarr këtë:

### AKT GJYKIM

**APROVOHET PJESËRISHT** si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit [REDAKTUAR] nga [REDAKTUAR] dhe **OBLIGOHET** e paditura KS "[REDAKTUAR]".- [REDAKTUAR], që paditëses në emër shpërblimit të dëmit të pësuar, t'ia paguaj shumat si vijojnë:

**1. në emër të dëmit jomaterial:**

- për shkak të dhimbjeve fizike të përjetuara shumë prej 2.500.00 €,
- për frikën e përjetuar shumë prej 1.500,00 €,

**2. në emër të dëmit material:**

- për ndihmën dhe përkujdesjen e huaj shumë prej 100.00 €
- për ushqim të përforcuar shumë prej 80.00 €

,e që shuma e përgjithshme e shpërblimit i bie **4.180.00 € (katërmijënjedëzetdhjetëeuro)**, të cilën shumë e paditura është obliguar t'ia paguaj së bashku me kamatën e cila llogaritet duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë (04.12.2008) e deri në pagesën definitive, sipas lartesisë që llogarisin bankat për deponimet e zakonshme të qytetarëve për periudhë njëvjeçare pa destinim të caktuar, si dhe shpenzimet e kësaj procedurë në shumë prej 563.44€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishëmrisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbairmit me dhuën.

**REFUZOHET**, pjesa e kërkesëpadisë, përtej lartesisë së shumave të aprovuara për format e dëmit jomaterial dhe material, ndërsa përkitazi me kërkesat në emër të dëmit material për rehabilitimin fizioterapeutik refuzohet si e pabazuar.

### Arsyetimi

Patësi me padi dhe parashtrimet e bëra në seancat e mbajtura ka pretenduar se në aksidentin e datës 11.05.2008, për shkak veprimeve të kundërligjshme të të siguruarit të paditues që ka ndërmarr gjatë pjesëmarrjes në komunikacion, i ka shkaktuar paditësit lëndime trupore, për të cilat është përgjegjës civilisht është e paditura mbi bazën e rregullave të autopërgjegjesisë- për demet e shkaktuara personave të tretë.

Ka pretenduar se lëndimet trupore janë vërtetuar mjaftësisht nga ekspertët e lëmisë respective dhe se në pajtim me natyrën dhe shkallën e lëndimeve, lartësia e kërkesave për shpërblim të dëmit është e drejtë, andaj i ka propozuar kësaj gjykate që të njëjta t'i aprovoj në tërësi si të bazuara.

E paditura, permes perfaqesuesit te saj, ne pergjigje ne padi si dhe kundershtimet e bera ne seancat e mbjatura ka kontestuar padine e paditeses si per nga baza ashtu edhe lartesia duke kontestuar ato si tejet te larta, ndersa sa i perket bazes se kerkesepadise e kane kontestuar ne kuptimin se e paditura ka legjitimitet pasiv ne kete ceshtje, per faktin se shkaktesesi I demit-drejtuesi I automjetit ka drejtuar ate pa autorizim nga pronari.

Gjykata me qellim te vertetimit te drejte te gjendjes faktike te ceshtjes, per aq sa palët ndërgjygjëse i parashtruan ato në këtë procedurë, bazuar në nenin 319.1 të LPK-së, ka bërë administrimin e provave si vijojnë:

Procesverbali dt.11.05.2008 BD 0767 me shtojca, raporti specialistik dt 29.07.2008-klinika [REDAKTUAR], raporti specialistik dt.02.06.2008, raporti I mjekut specialist te spitalit arab te Vushtrrise nr.1118, raporti I neurokirurgut [REDAKTUAR] dt.05.07.2008, raporti I QSh Mitrovice nr.1902 dt.20.05.2008, raporti I analizave hetamotologjike QE ne Prishtine dt.11.05.2008, raporti I QKUK nr.4309 dt.23.05.2008, mendimi dhe konstatimi I I ortopedit-traumotologut dr. [REDAKTUAR] I dhene ne seancen e dates 20.05.2010, shiqimi I fotodokumentacionit, raportet e mjekeve specialist dative, 13.05.2008 nr.1038, 11.05.2008, 14.05.2008, raporti QKUK 15532, faturat dhe kuponat , aktvendimi I GJK Mitrovice P.nr.1/09 dt.05.08.2009, mendimi dhe konstatimi I psikiatrit dr [REDAKTUAR] I dhene ne seancen e shqyrtimit kryesor.

Gjykata, pas administrimit të provave, ka bërë shqyrtimin e provave vec e vec si dhe të ndërlidhurae varura reciprokisht mes veti si teresi, mbi bazën e bindjes së saj të lirë në kuptim të nenit 8 par.1 dhe 2 të LPK-së, ka gjetur se duhej vendosur si në dispozitiv.

Gjykata në këtë çështje, në mes palëve ndërgjygjëse si kontestsuese i ka gjetur faktet (më me relevance ne zgjidhjen e drejte te ceshtjes) lidhur me pergjegjesisine juridike e te paditures per shperblimin e demit, si dhe faktet lidhur me lartesine e shumave te kerkuara nga paditesja ne emer te demit material dhe jomaterial.

Faktet tjera të çështjes gjykata i kualifikojë në grupin e fakteve jokontestsuese.

Gjykata ka refuzuar ne seancen e dates 29.07.2013, propozimin per terheqjen e padise ndaj te paditures, per faktin se i autorizuari i paditesit ne rastin konkret nuk ka patur nje autorizim te tille respektivisht autorizimet e tija , duke mos qene si i autorizuar avokat, nuk shtriheshin me efekt ligjor, ne kete drejtim, pa marrjen e autorizimit te vecant shprehimor nga vet paditesi, ndaj meqe atij i mungonte autorizimi i vecant nga paditesi, per te bere terheqjen e padise , gjykata ka gjetur se propozimi ne fjale i te autorizuarit te paditesit, duhej refuzuar.

Gjykata lidhur me faktin kontestues të shkallës së përgjegjësise së të paditures,ka vertetuar faktin se aksidenti i dates 11.05.2008, eshte shkakuar per shkak te veprimeve te kunderligjshme te drejtuesit te automjetit Mercedes me targa 201-KS-385, te cilin e drejtonte i mituri [REDAKTUAR] ( i cili automjet ka qene i siguruar tek e paditura) qe ka ndermarr drejtuesi i saj gjate pjesemarrjes ne komunikacion ku si pasojë paditesit i jane shaktuar lendime trupore dhe se per shkak te veprimit te paligjshem qe ka ndermarr i siguruari i te paditures, e paditura ka pergjegjesine juridiko-civile, per kompenismin e demit duke qene se drejtuesi i automjetit ka zoteruar auomjetin e siguruar tek e paditura, kur ka marre pjese ne komunikacion, nen mbulesen qe i ka ofruar polica e sigurimit te te paditures, peese perkitazi me demet eventuale qe mund te shkaktoheshin gjate levizjes se ketij automjeti, andaj e paditura eshte gjetur pergjegjesese civilisht para paditesit per demet qe ka pesuar ai nga levizja e ketij automjeti ne kuptim te nenit 173 lidhur me nenin 178 dhe nenit 940 te LMD-se,

Mes palëve në kontest, kontestuese ishte edhe jomaterial e shumave të kërkuara nga paditësi në emër të dëmit jomaterial dhe material, për të gjitha figurat e dëmit të kërkuara, andaj me qëllim të vërtetimit të drejtë të shkallës dhe natyrës, intenzitetit, kohezgjatjes dhe pasojave të lëndimeve që ka pësuar paditësi, gjykata ka marrë parë në anë të ekspertimit nga ekspertët e lëmisë së ortopedise-traumatologjise, dhe psikiatrise, të cilët mendimin dhe konstatimet profesionale i kanë dhënë në seancën e datës 20.05.2010 dhe 22.08.2013.

Nga konstatimi i ekseptit të ortopedise-traumatologjise Dr. [REDAKTUAR], i cili në mendimin e dhene ka konstatuar se tek paditesit, si pasojë e aksidentit të pësuar, i janë shkaktuar lëndimet trupore, me kete natyre dhe ne kete shkalle:

Ndrydhje të kokës, krahorrit, perdredhje të regionit të qafës.

Lëndimet e tilla janë kualifikuar si lëndime të natyrës së lehtë, të cilat tek paditësi janë manifestuar me dhimbje fizike të intenzitetit posaqërisht të rëndë në kohezgjatje prej 30 ore e reduktuar më pas në intenzitet të lartë 30 dite pastaj të mesëm për 10 dite dhe intenzitet të lehtë 30 dite.

Gjykata mendimin e ekspertit lidhur me natyren, shkallen dhe intezitetin e dhimbjeve fizike e vleresoj si profesionale dhe të drejta, duke i gjykuar për kete figure të dëmit shumen prej 2500€, si shperblim adekuat me natyres dhe shkallen e dëmit të pësuar nga paditesit.

Lidhur me natyren, intenzitetin dhe kohezgjatjen e frikes, gjykata ka vleresuar sit e drejte dhe profesionale mendimin e ekspertite psikiatrise Dr. [REDAKTUAR], kur ka konstatuar ekzistimin tek paditesit të frikes sekondare të intenzitetit të lartë në kohezgjatje prej 48 ore që është manifestuar si ankth, shqetesim dhe pasiguri. Frika sekondare me pas ka kaluar në intenzitet të mesëm dhe ka zgjatur 15 dite duke u reduktuar me pas në intenzitet të ulte në kohezgjatje prej 2 muaj. Kjo formë e dëmit tek paditesit është manifestuar si ankthe dhe shqetesime për të ardhmen e tij, e cila ka ndikuar në reduktimin e performances së tij në aktivitete shoqerore dhe familjare për arsye të crregullimit të gjumit, preokupimeve të vazhdueshme për fatin e shëndetit të tij e cila ka zvogeluar shprehjen e personalitetit të paditesit duke shtuar pasiguri tek ai, mendime negative dhe disponimit të ulte për aktivitetet e jetes së perditshme, andaj për keto arsye e duke patur parasysh gjykata ka gjykuar pjesërisht shumen e kerkeuar në emër të kesaj figure të dëmit jomaterial.

Gjykata, për të gjitha këto forma të dëmit jomaterial, paditësit i ka gjykuar shumat si në dispozitiv, duke u bazuar edhe në bindjen e saj të lirë, të krijuar nga procesi i gjithmbarshëm i këtij shqyrtimi gjyqësor, me synim se vlerat e gjykuara paditesit kurre nuk do të mund t'ia rikuepronin gjendje shëndetsore që kishte para aksidentit, por se atij zhvendim do t'i shërben si satisfaksion moral për të mirat e që ka humbur në dëmtimin e shëndetit të tij dhe kjo pagesë tek ai do të ketë sado pak ndikim pozitiv në këndelljen e shëndetit të tij në të ardhmen duke krijuar tek ai ndjenjen e besimit për vazhdimin e jetes së metejme.

Gjykata shumat e aprovuara i ka gjykuar paditëses bazuar në nenin 323 të LPK-së dhe nënve 185 paragraf 3 lidhur me nenin 200 të LMD-se, në emër të shperblimit i cili në kete rast nuk ka qëllimin e rikthimit të të mirës së demtuar tek paditesit, por se ka për qëllim rivendosjen e ekuilibrit të c'rregulluar në gjendjen shpirtërore të paditesit, duke i dhene atij një satisfaksion moral, se dikush është gjetur fajtor për prishjen e shëndetit të tij për c'gje i është detyruar atij me kete formë të "shperblimit të dëmit të plote".

Gjykata ka refuzuar kerkesen e paditesit per shpenzimet e rehabilitimit fizioterapeutik, per faktin se per nje shpenzim te tille ka mundur gjykates t'i provohet me prova materiale-faturo, por te njejtat paditesi nuk i ka provuar ne kete procedure.

Gjykata, paditësit i ka gjykuar, ne emer te demit material, shumën prej 100.00€, në emër të ndihmës dhe përkujdesjes së personit të tretë per 10 dite dhe shumen prej 80.00€ per ushqimin e perforcuar, duke patur parasysh natyrën e lëndimeve që ka pësuar paditësi, qe per gjykaten e bëne te besueshëm faktin se paditësi doemos ka patur nevojë për ndihmen e nje personi te trete, për të kryer nevojat më elementare te jetësore, duke marre per bazen regjionin e lednimeve qe kane qene ne pjesen e kokes dhe ushtrimi I mbikqyrjes ndaj tij ka qene I domosdoshem per gjate 10 diteve te para pas aksidentit dhe gjithashtu ushqimi me kalori, vitamina dhe minerale ka qene i nevojshem per te rigjeneruar qelizat ne rikuperimin dhe konsolidimin e pjesës kockore te dëmtuar si dhe ndrydhjet dhe gjakderdhjet e brendshme qe ka pesuar. Ketë vlerësim gjykata e mbështet në vlerësimin e saj të lirë bazuar në nenin 323 te LPK-së nderlidhur me konstatimet mjeksore te eksperteve, per faktin se tani eshte e ditur per gjykates dhe si i qenë fakti se paditesi ka shfrytezuar ndihmen e personit te trete dhe se ai ka konsumuar ushqim te perforcuar ndonese, per keto dy kategori te kerkesave ajo nuk ka prezantuar prova per te deshmuar vleren e tyre, gjykata ka gjykuar shumat e lartecekura mbi bazen e bindjes se saj te lire.

Gjykata e ka obliguar te padituren qe paditesit t'ia paguan kamaten per shumen e aprovuar, nga dita e ushtrimit te padise ne baze te nenit 277 lidhur me nenin 186 te LMD-se.

Vendimin mbi shpenzimet e procedures kontestimore gjykata e ka bazuar ne nenin 452 parag.1 te LPK-se, duke ia njohur paditesit shpenzimet e kesaj procedure per taksen per padi dhe aktgjykim si dhe shpenzimet per ekspertet ne shume prej 250.00€.

Andaj, gjykata bazuar ne nenin 2,5,29,142 dhe 160 te LPK-se, ka vendosur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ**

**C.nr.107/13 date 22.08.2013**

REPUBLIKA E KOSOVËS

- Ac. nr. 3337/13

VENDIMI ËSHTË I MËDHEMDOISHËM  
CHLURA  
GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ  
KOSOVA



Gjyqtari,  
Enes Mehmeti

**Keshilla Juridike:** Kunder ektoj aktgjykimi eshte e lejuar ankesa ne afat prej 15 ditesh, pas pranimit te kopjes se tij, ne gjykaten e Apelit ne Prishtine, permes kesaj gjykate.

